



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 2527/Prot.
3

Gramsh, më 03. 07. 2026

V E N D I M

Nr. 46 , datë 30/06/2026

MBI

MIRATIMIN E SUBVESIONIMIN E TARIFËS SË PAGESËS PËR KULLOTAT E
LIVADHET PËR FERMERËT E QË KANË KONTRATË QIRAJE NË EKONOMINË
PYJORE/KULLOSORE VIDHAN - SKËNDERBEGAS.

Këshilli i Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 30.06.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 3, gërma “ç”, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/ b, neni 54 gërma “f, k”, të ligjit nr.111, datë 31.10.2024 Për disa ndryshime në ligjin 9693, datë 19.03.2007”, “Për Fondin Kullosor” i ndryshuar, nenit 15 (përdorimi për kullotje), pikat 1,2,3,4,5 dhe 6, nenit 17 (përdorimi i sipërfaqes dhe tokës), nenit 27, të VKM nr.467, datë 31.07.2025 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme”, të VKM nr.684, datë 02.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit nr.02, datë 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”, të relacionit për subvencionimin e tarifës së kullotës për fermerët që kanë lidhur kontrata qiraje për kullota dhe livadheve në fondin pyjor/kullosor publik, ekonomia pyjore/kullosore vidhan-skënderbegas, bashkia Gramsh:

V E N D O S I:

1. Të shpreh dakortësinë për subvesionin e fermerëve :
1.Pelivan Braçi 32000 lekë/vit, 2.Myslim Koçia 41400 lekë/vit, 3.Qemal Shimi 49000 lekë/vit,
4.Kaniqe Doce 67750 lekë/vit, 5.Muhamet Nazari 77500 lekë/vit, vlera totale = 267,650

lekë/vit të tarifës së pagesës për fermerët që kanë kontrata qiraje për kullota dhe livadhe, në ekonominë pyjore/kullosore Vidhan – Skënderbegas.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Pyjeve, Bujqësisë dhe Turizmit së Konsumatorit pranë Bashkisë Gramsh.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Xhulia GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT

